



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Peshkopi, me ____ 2024

P/ VENDIM

Nr. 02, date 29.04.2024

**"PËR NJE SHTESE NE VENDIMIT NR.28 DATE 05.04.2024, PËR MIRATIMIN E AKTIT
TE THEMELIMIT DHE STATUTIT TË SHOQËRISË SË BASHKEPUNIMIT BUJQËSOR
"OPERATORI I RRUGEVE RURALE DHE TURISTIKE (ORRT)"**

Ne mbështetje te nenit 113 te Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 9, te nenit 14 e vijues, nenit 54 germa "d" te ligjit Nr. 139/2015, date 17.12.2015, "*Për Veteqeverisjen Vendore*", te ndryshuar, ligjit Nr.38/2012 "Per shoqerite e bashkepunimit bujqesor", ligjit Nr. 9901, date 14.4.2008, "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare", pasi shqyrtoi permbajtjen e Aktit te Themelimit dhe Statutin e Shoqerise se Bashkëpunimit Bujqesor "Operatori i Rrugeve Rurale dhe Turistike" ("ORRT"), me propozim te kryetarit te Bashkise.

KERKOJME:

1.Miratimin e Aktit te Themelimit dhe Statutin e Shoqerise se Bashkëpunimit Bujqësor "Operatori i Rrugeve Rurale dhe Turistike" ("ORRT") që do te nenshkruhet nga anetaret themelues: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Mat, Bashkia Klos, Bashkia Bulqize, Bashkia Diber, Agjencia Ekonomike Mbështetese "AEM Sh.p.k., Agjencia e Menaxhimit te Investimeve "AMI" Sh.p.k., HUBEX-Qendra e Ekselences per Dije dhe Inovacion, dhe AGREGATORI- Qendra për Zhvillim,Partneritet dhe Mireqeverisje.

2.Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Diber për nënshkrimin e Aktit të Themelimit, Statutin e Shoqerisë së Bashkëpunimit Bujqesor "Operatori i Rrugeve Rurale dhe Turistike" ("ORRT") dhe çdo akti tjetër te nevojshëm per krijimin, regjistrimin dhe funksionimin e kesaj shoqerie-si-perfaqesues-i-anetarit-themelues, Bashkia Diber.

3.Me zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Sherbimeve Publike,Bashkia Diber.

4.Ky vendim hyn ne fuqi pas miratimit nga ana e miratimit nga ana e Keshillit Bashkiak Diber dhe shprehjes per besueshmerine ligjore nga institucioni i Prefektit te Qarkut Diber.

PER BASHKINE DIBER

Inxhinieri I Dr. Sherbimeve Publike

Bedri SHEHU

Dr. Juridik

Ismet SARAÇI

Drejtori Finances


Çiljeta ZUNA

Dr.Sherbimeve Publike

Bedri KAMBERI

KRYETARI I BASHKISE

Rahim SPAHIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBER

Nr. Prot

Peshkopil, më ____ .04.2024

RELACION

"PËR MIRATIMIN EAKTIT TE THEMELIMIT DHE STATUTIT TE SHOQËRISË SE
BASHKEPUNIMIT BUJQËSOR "OPERATORI I RRUGEVE RURALE DHE TURISTIKE
(ORRT)"

Me vendimin Nr.255, date 31.01.2024 te Keshillit Drejtues te FSHZH-se, eshte vendosur miratimi i themelimit et operatorit per hapjen dhe mirembajjen e rrugeve rurale dhe turistike (rruge të bardha) ne bashkepunim me njësite e veteqeverisjes vendore, duke filluar ushtrimin e veprimtarise me zbatimin e projektit pilot ne qarkun Diber

Bashkia Diber, si njesi e veteqeverisjes vendore, ne mbeshtetje te parashikimeve et ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" (i ndryshuar), nenit 27 te tij, ne te cilin percaktohet se, nje nga funksionet e bashkive eshte ajo, ne fushën e bujqesise, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, sipas mënyres se percaktuar me ligj, e vlereson me rëndesi themelimin ekesaj shoqerie et bashkepunimit bujqesor "Operatori iRrugëve Rurale dhe Turistike" (ORRT) me qellim ritjen e mireqenies se banoreve dhe zhvillimin e zonave rurale dhe atyre me potencial zhvillimi, duke synuar:

1. Permiresimin e aksesit dhe konektivitetit midis ketyre zonave dhe akseve kombëtare apo gendrave urbane;
2. Zgjimi i potencialeve per zhvillim dhe mbeshtetja e iniciativave te reja siper marrëse ne këto zona;
3. Formësimin e sinergjisë mes aktorëve lokalë, qofshin ata publik, qendror apo vendor, siper marrje private, organizma jofitmi prures, apo komunitete lokale;
4. Ngritjen reformave te reja dhe inovatore te qeverisjes siper marrëse, duke ngitur modele bashkëqeverisjeje dhe partneritete rajonale mes njesive te veteqeverisjes vendore;
5. Ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve teknike, ekonomike, njerzore, te njesive te veteqeverisjes vendore apo ndermarrjeve/ njesive në varësi te tyre;

Krijimi i shogërisë se bashkëpunimit bujqesor "Operatori i Rrugëve Rurale dhe Turistike" (ORRT) shte ne zbatim te percaktimeve te ligjit Nr.38/2012 "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor", ku ne objektin e veprimtarise se saj eshte identifikimi, inventarizimi, vleresimi,

projektimi, ndërtimi, administrimi dhe mirembatja e rrugëve rurale, turistike dhe bujqesore, etj, te cilat nuk perfshihen ne inventarin e rrugëve kombëtare.

Vlera e kapitalit te shoqerisë qe do te themelohet eshte 100,000 (njqind mije) leke, i cili ndahet në 9 (nënte) kuota qe do te zoterohen nga anëtarët themelues sipas ndarjes ne tabelen si më poshte:

Anetari	Kuota	Numertimi	Perqindja e zoteruar ne kapital	Vlera nominale
Fondi Shqiptar I Zhvillimit (FSHZH)	1	1	51%	52.000
Bashkia MAT	1	2	10%	10.000
Bashkia KLOS	1	3	10%	10.000
Bashkia BULQIZE	1	4	10%	10.000
Bashkia DIBER	1	5	10%	10.0000
“Agjencia Ekonomike Mbeshtetese” AEM shpk	1	6	2%	2.000
“Agjencia e menaxhimit te investimeve” AMI shpk	1	7	2%	2.000
“HUBEX-Qendra e Ekselences per Dije dhe Inovacion”	1	8	2%	2.000
“AGREGATORI-Qendra Zhvillim,Partneritet Mireqeverisje”	per dhe	1 9	2%	2.000

Marreveshja e perbashket ndermjet njesive te veteqeverisjes vendore dhe institucioneve të qeverisjes qendrore per krijimin/ themelimin e personit juridik te ndare nga palët, shoqerise së bashkëpunimit bujqësor "Operatori i Rrugëve Rurale dhe Turistike" (ORRT) mbeshtetet në parashikimet e:

Nenit 14 et Kreut V "Bashkepunimi mes njesive te veteqeverisjes vendore" et ligjit Nr. 139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore" te ndryshuar, nder te tjerash percaktohet se, citojme:

"...5. Dy ose me shume njesi te veteqeverisjes vendore, brenda nje qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione te qeverisjes qendrore, mund te lidhin marreveshje të perbashkët per krijimin e nje personi juridik ët ndare nga palët, ët cilit ijapin autoritet dhe kompetenca te caktuara. Në kuptimin e ketij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave et perbashkita. Per secilen pale percaktohet ndihmesa financiare, ndihmesa me sherbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjes te kualifikuar ose cdo aset tjetër i nevojshem per permbushjen e objektivave.

Ndersa ne nenin 54 "Detyrat dhe kompetencat e keshillit bashkiak" germa "d" e tij, te ligjit Nr. 139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore" et ndryshuar, percaktohet se, citojme:

"Keshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:... d) miraton aktet e themelimit ët ndermarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe et personave ët tjere juridike që krijon vetë ose me et cilet eshtë bashkëthemelues;."

- Bashkëlidhur Projekt - Vendimit giendet dhe Draft Akti i themelimit dhe Statutin e shogërise s Bashkëpunimit Bujqesor "Operatori i Rrugëve Rurale dhe Turistike" (ORRT

- Sa me sipër, bazuar ne dispozitat ligjore, konkretisht, nenit 13 të Kushtetutes se Republikes ës Shiperise, et nenit 9, et nenit 41 e vijues, nenit 54 germa "d" et ligjit Nr. 139/2015, date 17.12.2015, "Për Veteqeverisjen Vendore", et ndryshuar, ligjit Nr.38/2012 "Per shoqerite e bashkëpunimit bujqesor", ligjit N.r 9901, date 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar, kerkojme nga Keshilli i Bashkise Diber: 1. Miratimin e Aktit te Themelimit dhe Statutin e Shoqerise se Bashkepunimit Bujqësor "Operatori i Rrugeve Rurale dhe Turistike" ("ORRT") qe do te nënshkruhet nga anëtarët themelues: Fondi Shiptar i Zhvillimit, Bashkia Mat, Bashkia Klos, Bashkia Bulqize, Bashkia Diber, Agjencia Ekonomike Mbeshtetëse "AEM" Sh.p.k., Agjencia e Menaxhimit ët Investimeve "AMI" Sh.p.k., HUBEX-Qendra e Ekselences per Dije dhe Inovacion, dhe AGREGATORI- Qendra per Zhvillim, Partneritet dhe Mireqeverisje.

2 Autorizimin e Kryetarit ët Bashkise Diber per nenshkrimin e Aktit te Themelimit, Statusin e Shoqerise se Bashkëpunimit Bujqesor "Operatori i Rrugëve Rurale dhe Turistike" ("ORRT") dhe cdo akti tjetër qe eshte I nevojshem per krijimin, regjistrimin dhe funksionimin e kesaj shoqërie si perfaqësues i anëtarit themelues, Bashkia Diber.

3. Ngarkohet Kryetari i Bashkise per zbatimin e ketij vendimi.

Inxhinieri I Dr. Sherbimeve Publike

Bedri SHEHU



Dr. Juridik

Ismet SARAÇI

